

## Braktisja e namazit (vazhdim)

All-llahu të ka krijuar dhe të ka dhënë çdo gjë që e ke. **“Thuaj: “Ai është që ju krijoi, ua dhuroi të dëgjuarit, të parit dhe mendjen, kurse pak po e falënderoni.”** Kur’an 67:23

Këmbët e Muhammedit (paqja qoftë mbi të) enjteshin duke qëndruar në namaz për një kohë të gjatë. Kur e pyetën për këtë, ai tha, **“A mos të jem rob falenderues?”**

## Po tregoni përtaci

Çfarë justifikimi keni përgatitur për Krijuesin tuaj, Krijuesin e qiejve e të tokës, në ditën e gjykimit? Ai që ju ka bekuar me 24 orë në ditë, ju urdhëroi juve ta falni namazin, urdhër për zballimin e të cilit nuk të duhen më shumë se 30 minuta!

Muhammedi (paqja qoftë mbi të) ka thënë, **“Nuk do të lëvizë këmba e birit të Ademit Ditën e Gjykimit derisa të pyetet për katër gjëra: për jetën e tij se ku e ka harxhuar; për rininë e tij se ku e ka shfrytëzuar; për pasurinë e tij se nga e ka fituar dhe ku e ka harxhuar; dhe për dijen e tij se çfarë ka punuar me të.”**

## Do të jeni të trishtuar (të mjerë)

All-llahu thotë, **“E kush ia kthen shpinën udhëzimit Tim, do të ketë jetë të vështirë dhe në ditën e kijametit do ta ringjall të verbër. Ai (që nuk besoi) do të thotë: “Zoti im, përse më ngrite të verbër, kur unë isha me sy? Ai (All-llahu) thotë: “Ashtu si i harrove ti argumentet Tona që t’i ofruam, ashtu je ti i harruar sot.”**

Kur’an 20:124-126

## Jeni duke e dëmtuar veten tuaj

All-llahu nuk ka nevojë për namazin tuaj, ose ndonjë gjë tjetër – i pastër është Ai! Jeni ju ata që keni nevojë për mëshirën e Tij.

**“Të falënderosh All-llahun, e kush falënderon, e mira e atij falënderimi i takon atij, e kush refuzon (edhe ai e ka për vete), në të vërtetë, All-llahu nuk ka nevojë (për falënderimin e tij) pse Ai vetë është i lavdishëm.”**

Kur’an 31:12

## Justifikimet e zakonshme

**Nuk kam kohë (punë, studime, i zënë, etj):** Vetëm mashtrim i vetëvetes. Sepse nëse i jepni rëndësi namazit (e bëni prioritet). All-llahu do të bekoj kohën tuaj dhe do të ju bëjë juve më efektivë, efikasë dhe të suksesshëm.

**Zemra ime është e pastër:** All-llahu gjykon kush ka zemër të pastër, dhe Ai dëshiron që ti të falesh! Veprimet pasqyrojnë atë që është në zemrën tënde. Askush nuk ka zemër më të pastër se Profeti Muhammed (paqja qoftë mbi të) i cili falej rregullisht.

**Alarmi:** Është e vështirë që alarmi të cingërrojë, në qoftë se ti nuk e kurdisë!!! Pastrojeni qëllimin tuaj dhe fleni sipas Sunetit.

**Familja ime / bashkëshorti-ja / prindërit / shokët më parandalojnë mua:** Profeti (paqja qoftë mbi të) ka thënë, **“Nuk ka bindje ndaj askujt në mosbindje ndaj All-llahut.”** Ju do të gjykoheni vetëm.

**Kam bërë shumë mëkate:** Me kalimin e kohës, namazi juaj do të ju ndalojë nga kryerja e këtyre mëkateve - vetëm faluni! Ju jeni mëkatar, sepse ju nuk jeni duke u falur.

Mendo për këtë hadith, **“Sikur ta dinin se ç’vlerë kanë namazi i jacticë dhe i sabahut, ata do të vinin në xhami rrëshqanas (zhagaz).”**

Sinqerisht, çfarë justifikimi ke për braktisjen e namazit, në atë ditë të vështirë kur të dalësh para Zotit tënd?

## Në fund

Njëmend të ikësh te All-llahu nga problemet dhe jo të ikësh në probleme duke ia kthyer shpinën All-llahut, të frikësohesh singjerisht vetëm nga All-llahu të mbështetesh singjerisht dhe të shpresosh vetëm tek Ai, të kryesh çdo punë vetëm në emër të Tij.

Në këtë gjendje, zemra e njeriut lozë dhe fërgëllon e tëra nga gëzimi deri në atë masë sa njeriu mendon, **“Sikur xhenetlijtë do ta kalonin jetën në këtë gjendje atëherë me të vërtetë u është dhënë një e mirë e madhe.”** A e ke ndier këtë Xhenet? A e ke provuar shijen e tij? Nëse jo, atëherë nxito drejt tij, ngase edhe All-llahu i Madhëruar të fton atje.

### Informacion

tel 045 633 370 web islamifejavertete.com @broshurat@gmail.com

Emri i bankës Pro Credit Bank

Kontoja 1184001037000102 Swift MBKORS22

# Rëndësia e namazit



gjërat  
themelore

islamifejavertete.com

**M**jerisht, shumë muslimanë nuk falen apo nuk i plotësojnë kushtet e namazit, megjithë rëndësinë e tij të madhe. Qëllimi i namazit është të forcojë marrëdhëniet tona me Zotin, të jemi mirënjohës për të gjitha dhuntitë e Tij, dhe të përkujtojmë veten për madhësitinë e Tij. Ashtu sikur trupi që ka nevoja fizike, të tilla si ushqimi dhe uji, edhe shpirti ka nevojat e tij shpirtërore, të tilla si aktet e adhurimit, e më i rëndësishmi prej tyre është namazi. Mund të jetë që trupi i një personi është i shëndoshë, por personi është shpirtërisht i vdekur.

Muhammedi (paqja qoftë mbi të) ka thënë, **“Shembulli i atij që e përmend Zotin e tij, është sikurse shembulli i të gjallit dhe të vdekurit.”**

All-llahu thotë, **“O ju që besuat, përgjigjuni (thirrjes së) All-llahut dhe të të dërguarit kur ai (i dërguari) ju fton për atë që ju jep jetë, (për fenë e drejtë) dhe ta dini se All-llahu ndërhyr ndërmjet njeriut dhe zemrës së tij, dhe se ju do të tuboheni te Ai.”** Kur’an 8:24

## Rëndësia e namazit

### Komunikimi i drejtpërdrejt me All-llahun

**“Njeriu është më së afërti ndaj Allahut xh.sh. kur është në sexhde.”**

Namazi të lidh ty me All-llahun. Fjala arabe për lutje (As-Salah), rrjedh nga fjala arabe “lidhje”. I Dërguari i All-llahut (paqja qoftë mbi të) ka thënë, **“Me të vërtetë kur ndokush prej jush falet, ai komunikon me Zotin e tij.”** Prandaj mos e shpëput këtë lidhje me Zotin tënd.

### Ndër shtyllat më të rëndësishme të Islamit

Namazi është shtylla e dytë më e rëndësishme e Islamit, dhe është veprimi më i rregullt i detyrueshëm në jetën e një Muslimani. Namazi është një vepër e përditshme e cila duhet të kryhet, pa marrë parasysh rrethanat. Në të vërtetë, All-llahu nuk i përjashton nga namazi edhe ata muslimanë të cilët janë duke luftuar në betejë! Ai thotë,

**“Kryeni rregullisht namazin... E nëse këni frikë (nga armiku), atëherë faluni duke ecur ose duke kalëruar.”** Kur’an 2:238-239

I tillë është rasti gjatë luftës. Çfarë atëherë gjatë paqes?

### Suksesi varet nga namazi

Muhammedi (paqja qoftë mbi të) ka thënë, **“Gjëja e parë për të cilën robi do të jep llogari është namazi i tij; nëse namazi**

**është në rregull dhe si duhet, të gjitha veprat e tjera do të jenë në rregull, por nëse namazi i tij nuk është në rregull atëherë të gjitha punët e tjera nuk do të jenë në rregull.”**

## Përfitimet nga namazi

### Mburojë kundër së keqes

Pa kërkuar ndihmën e All-llahut, është e pamundur që të përmbahesh nga e keqja.

All-llahu thotë, **“Vërtet namazi largon nga të shëmtuarat dhe të irituarat...”** Kur’an 29:45

Si mund të bësh mëkate, kur qëndron me vetëdëshirë 5 herë në ditë para All-llahut?

### Pasuron shpirtin tuaj

Namazi kënaq nevojën tuaj shpirtërore që të jeni në kontakt me Krijuesin tuaj. Kjo i jep shpirtit tuaj paqe dhe kënaqësi, sidomos me stillin e zënë të jetës tuaj.

All-llahu thotë, **“Pra ta dini se me të përmendur All-llahun zemrat stabilizohen.”** Kur’an 13:28

### Ju bën të përlulur

Krenaria dhe arroganca ju largon nga madhështia e All-llahut dhe nga varësia juaj ndaj Tij. Në namaz, muslimani e vendos pjesën më të lartë të trupit të tij dhe burimin e intelektit, kokën e tij, në tokë dhe thote, **“I Dëlirë është Zoti im, i Lartë.”**

All-llahu thotë, **“Është e sigurt se kanë shpëtuar besimtarët, ata të cilët janë të përlulur dhe të kujdesshëm gjatë faljes së namazit.”** Kur’an 23:1-2

Sigurisht, kjo mund të arrihet vetëm kur ju e kuptoni se çfarë po thoni dhe të përqëndroheni në të me përlulësi.

### Ju falen mëkatet

Gjithkush bën mëkate, megjithatë, All-llahu na ka siguruar, në namaz, një mënyrë që të na falen këto mëkate.

All-llahu thotë, **“Dhe fale namazin... S’ka dyshim se veprat e mira i shlyejnë ato të këqijat.”** Kur’an 11:114

Muhammedi (paqja qoftë mbi të) u dha shokëve të tij një shembull shumë të bukur kur tha, **“Çka mendoni, sikur të ishte nje lumë para derës së njërit prej jush, në të cilin do të lahej për çdo ditë nga pesë herë, a do të mbetej në të ndytësi?”** Të pranishmit thanë, **“Nuk do të mbetej kurrëfarë ndytësie.”**

Pejgamberi (paqja qoftë mbi të), atëherë tha, **“Ky është shembulli i pesë kohëve të namazit. All-llahu me faljen e namazeve i shlyen mëkatet.”**

### I zgjidh problemet tuaja

Nëse i forconi marrëdhëniet tuaja me All-llahun, All-llahu do t’i forcojë marrëdhëniet tuaja me pjesën tjetër të krijesave. Përmes namazit, Ai i cili është i Gjithë-fuqishëm, do t’i zgjedhë problemet tuaja.

All-llahu thotë, **“Kërkoni ndihmë me durim e me të falur.”** Kur’an 2:153

### I bashkon muslimanët

Namazi me xhemat (në xhami) kultivon vëllazërinë, barazinë dhe përlulësinë në mes muslimanëve. Namazlinjtë qëndrojnë në rreshta si një trup, sup më sup afër njëri tjetrit pa dallim race, kombësie, pasurie apo statusi shoqëror. Ky akt i unitetit i largon të gjitha pengesat që qëndrojnë në mes njerëzve.

## Braktisja e namazit

**“O ti njeri, po ç’të mashtroi ty kundrejt Zotit tënd që është bujar e i urtë?”** Kur’an 82:6

### Nuk po i bindeni Krijuesit tuaj

I gjithë qëllimi i ekzistencës suaj është që të adhuroni vetëm All-llahun, por duke mos falur namazin, ju nuk po i bindeni Krijuesit tuaj.

**“E pas tyre (të mirëve) erdhën pasardhës të këqinj, që e lanë namazin e u dhanë pas kënaqësive (trupore), e më vonë do të hidhen në çdo të keqe. Me përjashtim të atij që pendohet dhe beson e bën vepra të mira, të tillët do të hyjnë në xhennet dhe atyre nuk u bëhet kurrëfarë e padrejtë.”** Kur’an 19:59-60

**“Çka u solli juve në Sekar (xhehenem)? Ata thonë: “Nuk kemi qenë prej atyre që faleshin (që bënë namaz)”** Kur’an 74:42-43

### Po bëheni jofalënderues

Refuzimi i kësaj ftese për të krijuar këtë marrëdhënie të ngushtë me Krijuesin tënd është refuzimi përfundimtar.